

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE BORDI

Gjatë muajit tetor Bordi i ERE-s ka zhvilluar 6 mbledhje, të cilat kanë rezultuar në 24 vendimmarrje, ndër të cilat, licencimi i një subjekti në prodhimin e energjisë elektrike nga central fotovoltaik, një subjekti në veprimtarinë e tregtimit dhe të furnizimit të energjisë elektrike si dhe miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2023 prej 16.06 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, por dhe vendime mbi çështje të brendshme të organizimit të institucionit.

Gjithashtu, ndër vendimmarrjet e tjera të marra gjatë këtij muaji përmendim:

✓ Refuzimin e kërkesës së shoqatës "AREA", "Për rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023 - Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023";

✓ Pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "ECO-ELB" sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW; Në datën 27.09.2023, shoqëria ECO-ELB sh.a. brenda afatit prej 6 muajsh të përfundimit të licencës në përputhje dhe me rregulloren e licencimit, paraqiti në ERE kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali TEC (përpunimi i mbetjeve urbane), Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW. Në vijim të këtij aplikimi, ndër të tjera, me vendimin Nr. 309 datë 30.10.2023, Bordi i ERE-s vendosi pezullimin e kësaj vendimmarrje për rinovimin e licencës së shoqërisë ECO-ELB sh.a. në kushtet që shoqëria aktualisht ka një licencë të vlefshme deri me datën 27.03.2024, dhe duhet të përcjellë në ERE kontratën e rinovuar me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për përdorimin e impiantit të incenerimit për prodhimin e energjisë elektrike, brenda afatit të përfundimit të licencës aktuale. Aktualisht shoqëria ECO - ELB sh.a. ka një licence prodhimi të energjise elektrike të vlefshme deri më 27.03.2024

✓ Miratimin e Rregullores së Alokimit në Hije të kapaciteteve (Shadoë Auction) në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri – Kosovë;

✓ Miratimin e kërkesës së OST sh.a. dhe KESH sh.a, për amendimin nr. 3 të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet palëve të sipërpërmendura, duke ndryshuar kohëzgjatjen e kontratës, nëpërmjet shtrirjes së efekteve të saj deri në datë 31.12.2023. Ky ndryshim erdhi si rrjedhojë e zgjatjes së periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri në datën 31.12.2023, me anë të VKM nr. 449, datë 26.07.2023 "Për një ndryshim në VKM nr. 584, date 08.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike (e ndryshuar)";

✓ Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e "Planit dhjetëvjeçar të investimeve nga Shoqëria Albgaz sh.a";

✓ Miratimin e dokumentit të përbashkët të dakortësuar me rregullatorin e Italisë (ARERA) dhe Greqisë (RAEWW). ("Mbi miratimin e "Projektit të TAP AG, SRG dhe DESFA për Procesin e Rritjes së Kapacitetit për vitin 2021"- Faza 2 detyrueses");

✓ Fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë së përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

Pjesë e axhendës mujore kanë qënë dhe seancat dëgjimore që lidhen me zgjidhjet e mosmarrëveshjeve mes të licencuarve, diskutime të palëve të interesit për çmime të përcaktuara nga ERE apo trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

Për t'u azhurnuar me informacion më të detajuar, shfletoni faqjen tonë zyrtare www.ere.gov.al.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCIME

Gjatë muajit tetor, Enti Rregullator i Energjisë ka filluar procedurat e licencimit për subjektet e mëposhtme:

“Swiss Balancing Pool” shpk, në veprimtarinë e tregtimit dhe të furnizimit të energjisë elektrike;

“M.C ENERGJI GOJAN” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga nga HEC Gojan, me kapacitet të instaluar 15 MW.



AKTIVITETE

SEKRETARIATI I KOMUNITETIT TË ENERGJISË ORGANIZOI NË DATËN 04 TETOR 2023, FORUMIN E KOMUNITETIT TË ENERGJISË NË TRANZICION TË DREJTË NË SHKUP, NJË MBLEDHJE E RËNDËSISHME QË SYNON ADRESIMIN E MASAVE THELBËSORE PËR NJË TRANZICION TË QËNDRUESHËM DHE TË BARABARTË ENERJITIK. KY AKTIVITET MBLODHI SË BASHKU RRETH 200 PJESËMARRËS, NDËR TË CILËT DHE PËRFAQËSUES TË ERE-S, DUKE NXITUR DISKUTIME KUPTIMLOTË, MUNDËSI LIDHJESH DHE SHKËMBIM NJOHURISH MIDIS PALËVE TË INTERESUARA NGA SEKTORË TË ENERGJISË PËR TRANZICIONIN ENERJITIK, BASHKËPUNIMIN RREGULLATOR DHE QËNDRUESHMËRINË PËRBALLË NJË SEKTORI QË EVLUON ME SHPEJTËSI. FORUMI U THELLUA NË TEMA KRITIKE THELBËSORE PËR GARANTIMIN E NJË TRANZICIONI TË DREJTË ENERJITIK, DUKE PËRFSHIRË PLANIFIKIMIN E POLITIKAVE, SFIDAT SOCIO-EKONOMIKE NË KOMUNITETET E VARUARA NGA QYMYRI, MEKANIZMAT E MBËSHTETJES FINANCIARE DHE NDIKIMET POZITIVE NË CILËSINË E AJRIT DHE BARAZINË SOCIALE QË RRJEDHIN NGA NJË TRANZICION I DREJTË.

NË DATAT 9 DHE 10 TETOR 2023 U ZHVILLUA NË BUDAPEST, HUNGARI KONFERENCA E 20 JUBILARE E ERRA (SHOQATËS SE RREGULLATORËVE TË ENERGJISË) ANËTAR I SË CILËS ËSHTË DHE ERE, ME TEMATIKË “DREJT NJË RREGULLIMI MË TË QËNDRUESHËM NËN KUSHTET E REJA TË TREGUT”.

NË KËTË KONFERENCË, NË TË CILËN U MBLODHËN EKSPERTË NGA VENDET ANËTARE TË ERRA-S DHE U DISKUTUA NDËR TË TJERA MBI TRANZICIONIN ENERJITIK, E CURITË E TREGJEVE NË VENDET ANËTARE DHE JO ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN, SFIDAT E PJESËMARRËSVE TË TREGUT, SFIDAT POLITIKBËRËSE DHE RREGULLATIVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ETJ.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË U PËRFAQËSUA NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM Z. ELTON B. RADHESI I CILI ISHTE GJITHASHTU PJESË E PANELIT TË DISKUTIMEVE DHE PREZANTOI MË TEPËR LIDHUR ME EKSPERIENCËN E ERE-S DHE SHQIPËRISË MBI MANDATIN E RREGULLATORËVE PËRGJATË TRANZICIONIT ENERJITIK, NËN KUSHTET E REJA TË TREGUT. GJATË PREZANTIMIT DHE DISKUTIMEVE NË PANEL, U VU NË DUKJE EKSPERIENCA E SHQIPËRISË LIDHUR ME MBËSHTETJEN E BURIMEVE TË RINOVUESHME ENERJITIKE, MASAT E MARRA PËR KALIMIN NGA SKEMAT E PPA-VE TEK KONTRATAT E DIFERENCËS DHE TREGTIMIN E TYRE NË BURSËN ENERJITIKE, E CILA PO FUNKSIONON PREJ MUJIT PRILL 2023, SI DHE SFIDAT ME TË CILAT MUND TË PËRBALLET RREGULLATORI NË TË ARDHMEN.

PËRGJATË KËSAJ CONFERENCE, U ZHVILLUA DHE ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQATËS PËR PRANIMIN E KËRKESËS SË RREGULLATORIT TË GREQISË, RAE, PËR T’U BËRË PJESËTAR, KËRKESË E CILA U PRANUA NË UNANIMITET NGA ANA E ANËTARËVE TË PRANISHËM NË ASAMBLE.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETORI ROZË

Tetori njihet në mbarë botën si muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, i njohur edhe si "Tetori Rozë". Për të katërtin vit radhazi, Europadonna organizoi maratonën Race for the cure Albania, pjesë e së cilës për këtë vit u bë dhe ERE, nëpërmjet pjesëmarrjes sensibilizuese por dhe kontributit sado të vogël për këtë kauzë. Kjo maratonë synoi të rriste ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit dhe të promovonte zbulimin e hershëm.



Kryetari i ERE-s, z.Petrit Ahmeti mori pjesë në datën 26.10.2023, në seksionin e tretë të tavolinës Itali - Shqipëri, mbajtur në Romë, pranë Ministrisë së Ambjentit dhe Sigurisë Energjetike të Italisë. Tavolina, e cila u hap nga Ministri i Ambjentit dhe Sigurisë Energjetike të Italisë z. Pichetto dhe zv.Kryeministrja dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë znj. Balluku, kishte në fokus ndër të tjera stadin aktual të bashkëpunimit midis dy vendeve, sfidat e së ardhmes mbi krijimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi si dhe projekteve në fushën e infrastrukturës energjetike midis dy vendeve. Në ndërhyrjen e tij, z. Ahmeti theksoi ndër të tjera raportet e bashkëpunimit mjaft të mira me rregullatorin Italian, në disa projekte të përbashkëta të shkëmbimit të eksperiencave rregulatore lidhur me integrimin e tregjeve të Ballkanit Perëndimor me vendet e BE-së, nëpërmjet seminareve, tavolinave teknike të punës etj. Gjatë kësaj tavoline u shkëmbye dhe u diskutua mbi projekte të përbashkëta nga TSO-të e elektricitetit dhe gazit si dhe qendrave të eficiencës së energjisë të të dy vendeve apo dhe bursave energjetike.

